



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71041-01568-11-2019	Data e Regjistrimit :	06/06/2019
Numri i Vendimit:	11-2019-3506	Data e Vendimit :	24/06/2019

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Nurjeta Tafa

SEKRETARE: Agelina Hristic

Sot më datë 24/06/2019mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}, i biri i {...} dhe i x, i datëlindjes {...}

Objekti:Heqjen e sekuestros preventive të vendosur mbi llogaritë bankare të kerkuesit {...}

Baza Ligjore:Nenet 274/3, 275 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të kërkuesit {...} dhe Prokurorit Gëzim Veizi, gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes si dhe dëgjoi në fazën e diskutimit përfundimtare palët të cilat kërkuan:

Kërkuesi: Pranimin e kërkesës dhe heqjen e masës së sekuestros preventive.

Prokurori: Pranimin e kërkesës.

VEREN :

Vëren:

I. **Rrethanat e çështjes**

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nga ana e kërkuetit {...} është paraqitur kërkesa për heqjen e masës së sekuestros preventive të vendosur në kuadër të procedimit penal Nr.442/2014, i regjistruar për veprën penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar në nenin 287 të K. Penal, duke qenë se me vendimin "*Për pushimin e çështjes*", datë 21.03.2017, prokurori ka vendosur pushimin e çështjes penale. Sipas akteve të këtij procedimi penal të administruara gjatë gjykimit rezultoi se me vendimin Nr.240, datë 19.03.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur masën e sigurimit pasuror sekuestro preventive mbi: **a)** llogaritë bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...} në llogarinë Nr. {...}; - llogari rrjedhëse në lekë gjendje {...} lekë; - llogari rrjedhëse në euro gjendje {...} euro; - depozitë njëvjeçare në leke gjendje {...} lekë; **b)** llogari bankare pranë Bankës {...} me emër biznesi ({...}) PF me numër llogarie 404289915 që ka këto të dhëna: -llogari rrjedhëse në lekë (gjendje {...} lekë); **c)** llogari bankare pranë Banka {...} në emër të shtetasit {...} {...}o, me këto balanca: - llogari rrjedhëse në lekë me Nr.{...} (gjendje {...} lekë); - depozitë me afat 3 muaj në lekë në Nr. llogarie {...} (gjendje {...} lekë). Në vijim, bazuar në faktin se nga ana e BKT-së ishte kthyer përgjigje se numrat e llogarive nuk ishin të sakta, prokurori i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për korrigjimin e vendimit dhe me vendimin Nr.240/1, datë 24.04.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur: **1)** vendosjen e masës së sigurimit sekuestro preventive mbi këto pasuri: **a)** llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...}, e përshkruar si depozitë në lekë me numër llogarie Nr.{...}; **b)** llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...}, e përshkruar si llogari rrjedhëse në lekë me numër llogarie Nr.{...}; **c)** llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...}, e përshkruar si llogari rrjedhëse në euro me numër llogarie Nr.{...} **d)** llogari bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare në emër të subjektit {...} (PF), e përshkruar si llogari rrjedhëse në lekë me numër llogarie Nr.{...}; 2) heqjen e sekuestros preventive mbi llogaritë rrjedhëse me numër {...} dhe {...} të përshkruar në vendimin Nr.240, datë 19.03.2014, pasi nuk lidhen apo i përkasin subjektit {...} Duke qenë se me vendimin "*Për pushimin e çështjes*", datë 21.03.2017, prokurori ka vendosur pushimin e çështjes, por pavarësisht kësaj prokurori nuk është shprehur për masën e sigurimit, kërkueti i është drejtuar gjykatës me kërkesën për heqjen e sekuestros, kërkesë me të cilën edhe prokurori u shpreh se ishte dakord.

II. **Analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës**

2. Pasi u njoh me kërkesën e kërkuetit {...}, me aktet e procedimit penal Nr.442/2014 si me qëndrimin e palëve në gjykim, vlerëson se kërkesa është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë ajo duhet të pranohet. Në rastin në gjykim rezultoi se sekuestro preventive është vendosur në kuadër të procedimit penal Nr.442/2104, i regjistruar për veprën penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar në nenin 287 të K. Penal. Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, në përfundim të hetimeve nga ana e prokurorit është vlerësuar se nuk provohet ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale pasi nuk provohet që nga vepra penale të jenë gjeneruar të ardhura. Për këtë arsye, me vendimin "*Për pushimin e çështjes*", datë 21.03.2017, prokurori ka vendosur pushimin e çështjes penale që i përket procedimit penal Nr.442, të vitit 2014, vendim me të cilën shtetasi {...} në cilësinë e përfaqësuesit të shtetasit {...} është njohur më datë 02.07.2018. Në referim të nenit 274/3 i K. Pr. Penale i cili parashikon se sekuestro preventive mund të hiqet nëse kushtet e zbatimit të saj kanë ndryshuar, rezultoi se kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të masës së sekuestros mbi llogaritë e kërkuetit {...} për sa kohë është vendosur pushimi i procedimit penal Nr.442/2014 me arsyetimin se nuk provohet ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale pasi nuk provohet që nga vepra penale të jenë gjeneruar të ardhura. Neni 274, paragrafi i parë dhe i dytë i K. Pr. Penale duke parashikuar vendosjen e sekuestros në rastet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi **që lidhet me veprën penale** mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ose për sendet, **produktet e veprës penale** dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, e ka lidhur caktimin e masës së sekuestros me ekzistencën e dyshimit për kryerjen e një veprë penale. Duke qenë se prokurori ka arritur në përfundimin se nuk është provuar që nga vepra penale të jenë gjeneruar të ardhura të cilat mund të konsideroheshin si produkt i veprës penale, atëherë nuk mund të vazhdojë më as zbatimi i masës së sekuestros preventive. Edhe pse me vendimin e datës 21.03.2017 prokurori ka vendosur pushimin e çështjes penale, prokurori nuk është shprehur në lidhje me masën e sekuestros preventive të vendosur mbi llogarinë e kërkuetit {...} dh për këtë arsye ato kanë vazhduar të qëndrojnë të sekuestruara pavarësisht kohës së kaluar nga vendimmarrja. Për këto arsye, në zbatim të nenit 275/1 të K. Pr. Penale, i cili parashikon se: "*Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuar për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale,*" duke qenë se në rastin në gjykim sekuestro e ka humbur fuqinë e saj me pushimin e çështjes penale, gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuetit {...} është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar. Në përfundim, shpenzimet gjyqësore në shumën 200 (dyqind) lekë, mbeten në ngarkim të kërkuetit {...} .

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar në nenin 274 dhe 275 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkesit {...}.
 2. Heqjen e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", të vendosur me vendimin Nr.240, datë 19.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi llogarinë bankare pranë {...} Bank në emër të shtetasit {...} me këto të dhëna:
 - llogari rrjedhëse në lekë me numër llogarie Nr {...};
 - depozitë me afat 3 muaj me numër llogarie Nr. {...};
 3. Heqjen e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", të vendosur me vendimin Nr.240/1, datë 24.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi llogaritë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare në emër të shtetasit {...} me këto të dhëna:
 - llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...} e përshkruar si depozitë në lekë me numër llogarie Nr. {...};
 - llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit \ {...}, e përshkruar si llogari rrjedhëse në lekë me numër llogarie Nr. {...}
 - llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të shtetasit {...}o, e përshkruar si llogari rrjedhëse në euro me numër llogarie Nr. {...}
 - llogari bankare pranë Bankës {...} në emër të subjektit {...}), e përshkruar si llogari rrjedhëse në lekë me numër llogarie Nr. {...}
 4. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë Durrës në ekzekutimin e këtij vendimi.
 5. Një kopje e këtij vendimi ti dërgohet {...} Bank dhe Bankës {...}.
 6. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
- U shpall sot në Durrës, më datë 24.06.2019.**

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	200
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:

Nurjeta Tafa